



PROKURORIA PUBLIKE E KOSOVËS  
JAVNO TUŽILAŠTVO KOSOVA

A nr.br.no. 123 /2011

Dt. 29.08.2011

PRISHTINË-PRISHTINA

**REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA**  
**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke u bazuar në nenin 4 pika 1.15 dhe nenin 15 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nxjerr:

### **Rregullore**

#### **Mbi caktimin e procedurave dhe kriterëve për Vlerësimin e Performancës së Prokurorive dhe Prokurorëve**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Me qëllimi të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës së prokurorive dhe prokurorëve, avancimit dhe promovimit të prokurorëve, zhvillimit të politikave dhe praktikave më të mira për ngritjen e një sistemi të pavarur, profesional e të paanshëm prokurorial, përcaktohen kriteret, metodat dhe procedurat e vlerësimit të performancës nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

##### **Neni 2**

##### **Kriteret për vlerësimin e performancës**

Vlerësimi i performancës së prokurorive dhe prokurorëve bazohet në këto kriterë:

1. kriteri sasior,
2. kriteri kohor;
3. kriteri i cilësisë; dhe
4. vet iniciativë,

### **Neni 3**

#### **Kriteri sasior**

Vlerësimi sipas kriterit sasior bazohet në:

1. numrin e kallëzimeve-lëndëve të zgjidhura,
2. mënyra e zgjidhjes dhe ndërlikueshmëria e kallëzimeve – lëndëve sipas:
  - 2.1 veprës ose veprave penale,
  - 2.2 numrit të personave të paraqitur, dhe
  - 2.3 akuzime pas hetimit.
3. parashtrimi i mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore.

### **Neni 4**

#### **Kriteri kohorë**

Vlerësimi sipas kriterit kohor bazohet në:

1. zgjidhjen e kallëzimeve penale dhe lëndëve tjera penale brenda afateve të përcaktuara me këtë rregullore,
2. respektimin e afateve ligjore të procedurës së hetimit;

### **Neni 5**

#### **Kriteri i cilësisë**

Vlerësimi sipas kriterit të cilësisë bazohet në:

1. raportin në mes të vendimeve gjyqësore dhe liruese,
2. raportin në mes të parashtrësve 2) të paraqitura nga prokurori dhe aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë apo të dytë,
3. raporti në mes të aktakuzave të konfirmuara, të kthyera në plotësim apo të hudhura.

### **Neni 6**

#### **Kriteri i vetiniciativës**

Vlerësimi sipas kriterit të vetiniciativës bazohet në:

1. numrin e procedurave penale të filluara drejtpërdrejtë,
2. numri i masave të diversitetit të shqiptuara nga prokurori
3. numri i kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë

### **Neni 7**

#### **Dërgimi i raporteve për punën e prokurorëve**

Vlerësimi sipas neneve 3,4,5 dhe 6 të kësaj rregullore bëhet në bazë të raporteve mujore të prokurorëve, të cilët janë të obliguar që në afat prej datës 1 e deri me datën 5 të çdo muaji ti dërgojnë raportet për muajin paraprak.

1. Raporti mujor i dërgohet shkrimores së prokurorisë përkatëse ,
2. Prokuroria -shkrimorja, raportet prokurorëve do t' ia dërgojë Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë deri me datën 10 të çdo muaji,

3. Mos dërgim i raporteve të kërkuara në kohën e duhur do të konsiderohet si mos përmbushje e detyrave të punës.
  - 1) Neni 306 paragrafi 2 dhe neni 316 pika 1-4 e KPPK
  - 2) Ankesat kundër aktvendimeve për refuzimin e konfirmimit të aktakuzës, ankesat kundër aktvendimit  
Të gjyqtarit të procedurës paraprake për refuzim të kërkesës për caktimin e paraburgimit

## **Neni 8**

### **Vlerësimi i punës duke u bazuar në kriterin sasior i shprehur në poenë**

#### 1. Numrin e kallëzimeve-lëndëve të zgjidhura :

- 1.1 Vlerësimi i punës së një prokurori behët në atë mënyrë që numri i kallëzimeve- lëndëve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik vihet në proporcion me normën e përcaktuar nga Këshilli Prokurorial për secilin nivel të prokurorive.
- 1.2 Lëndët penale kundër kryesve të panjohur vlerësohen në raporte me kryesit madhor të veprave penale në proporcion 1:20.
- 1.3 Lëndët e ndryshme penale vlerësohen në raport me kryesit madhorë të veprave penale në proporcion 1: 8.
- 1.4 Lëndët penale të shkallës së dytë, vlerësohen në raport me kryesit madhor të veprave penale nga kompetenca e PPQ-vë, në proporcion 1:3
- 1.5 Lëndët penale të shkallës së dytë, të shkallës së tretë dhe sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike, nga kompetenca e PSH-së,llogariten si lëndë penale të kryesve madhor të shkallës së parë të PPQ-së,
- 1.6 Shkalla e arritshmërisë së kriterit, përqindja dhe numri i mundshëm i poenëve:

• Deri në 40% të normës	0 poenë
• Nga 41% deri në 60% të normës	1 deri 5 poenë
• Nga 61% deri në 90% të normës	6 deri 15 poenë
• Nga 91% deri në 100% të normës	16 deri 25 poenë
• Mbi 100% të normës, për çdo 10% mbi normë fiton një (1) poen,	

Numri maksimal i poenëve mbi normë është 30 poenë.

#### 2. Mënyra e zgjidhjes dhe ndërlikueshmëria e kallëzimeve - lëndëve sipas:

- 2.1 veprës ose veprave penale,
- 2.2 numrit të personave të paraqitur, dhe
- 2.3 akuzime pas hetimit.

Nëse një prokuror nga numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të zgjidhura gjatë vitit kalendarik, ka zgjidhur mbi 25% të kallëzimeve penale të natyrës së ndërlikuar vlerësohet me 15 poenë<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>) Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me klasifikimin e lëndëve të ndërlikuara

3. parashtrimi i mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore.  
Nëse një prokurori gjatë vitit kalendarik i aprovohen :
  - 3.1 Nga 50% deri në 75% të mjeteve juridike vlerësohet me 5 poenë
  - 3.2 Mbi 76% të mjeteve juridike vlerësohet me 10 poenë

### **Neni 9**

#### **Vlerësimi i punës duke u bazuar në kriterin kohor i shprehur në poenë**

Zgjidhja e kallëzimeve penale dhe lëndëve tjera penale brenda afateve kohore të cekura më poshtë:

1. Shkalla e arritshmerisë së kriterit dhe numri i mundshëm i poenëve:
  - 1.1 Deri në 3 muaj, vlerësohet me 7 poenë
  - 1.2 Mbi 3 - 6 muaj, vlerësohet me 5 poenë
  - 1.3 Mbi 6 - 12 muaj, vlerësohet me 3 poenë
  - 1.4 Mbi 12 muaj, vlerësohet me 0 pena
2. Respektimi i afateve ligjore të procedurës së hetimit dhe ndjekjes penale;
  - 2.1 Nëse një prokuror gjatë vitit raportues i përfundon të gjitha hetimet e filluara brenda afateve ligjore vlerësohet me 5 poenë.
  - 2.2 Nëse një prokurori gjatë vitit raportues i parashkruhet ndjekja penale në më shumë se 2% të kallëzimeve të pranuar në punë vlerësohet me minus (-5) poenë.

### **Neni 10**

#### **Vlerësimi i punës duke u bazuar në kriterin e cilësisë i shprehur në poenë**

1. Raporti në mes të vendimeve gjyqësore dhe liruese,
  - 1.1 Prokurorit të cilit aktet akuzuese gjatë periudhës raportuese i kanë përfunduar mbi 80% me vendime gjyqësore, vlerësohet me 8 poenë.
2. Raporti në mes të parashtrësive të paraqitura nga prokurori dhe aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë apo të dytë,
  - 2.1 Prokurorit të cilit nga ankesat e parashtruara kundër vendimeve refuzuese apo lirues, gjatë vitit raportues, i janë aprovuar mbi 60% të ankesave, kërkesave dhe propozimeve vlerësohet me 6 poenë.
  - 2.2 Prokurorit të cilit nga ankesat e parashtruara kundër aktgjykimeve vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin i aprovohen mbi 60% të ankesave, vlerësohet me 3 poenë.
3. Raporti në mes të aktakuzave të konfirmuara, të kthyera në plotësim apo të hudhura.
  - 3.1 Prokurorit të cilit gjatë vitit raportues i janë konfirmuar mbi 90% të aktakuzave të ngritura vlerësohet me 3 poenë.

## Neni 11

### Vlerësimi i punës duke u bazuar në kriterin e vetiniciativës i shprehur në poenë

Numrin e procedurave penale të filluara drejtpërdrejtë,

1. Shkalla e arritshmërisë së kriterit dhe numri i mundshëm i poenëve:

- 1.1 Prokurori i Prokurorisë Komunale i cili me vetiniciativë fillon procedurën penale, në më shumë se 2% të numrit të përgjithshëm kallëzimeve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik, vetëm në bazë të asaj se ka dëgjuar se është kryer vepër penale vlerësohet me 10 poenë.
- 1.2 Prokurori i Prokurorisë së Qarkut i cili me vetiniciativë fillon procedurën penale, në më shumë se 5% të numrit të përgjithshëm kallëzimeve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik, vetëm në bazë të asaj se ka dëgjuar se është kryer vepër penale vlerësohet me 10 poenë.
- 1.3 Prokurori për të mitur i cili në më shumë se 2% të kallëzimeve të pranuar në punë i shqipton vetë masat e diversitetit vlerësohet me 10 poenë
- 1.4 Prokurori i shtetit i cili në më shumë se 2% të lëndëve të zgjidhura brenda vitit kalendarik paraqet drejtpërdrejtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë vlerësohet me 10 poenë.

## METODAT E VLERËSIMIT

### Neni 12

#### Notimi

1. Vlerësimi i punës së prokurorëve behët sipas kriterëve të vlerësimit përmes notimit
2. Notimi është tregues i rezultateve të punës së prokurorëve,
3. Rezultati i notimit shprehet me numrin e përgjithshëm të poenëve të mbledhur sipas të gjitha kriterëve.

### Neni 13

#### Llojet e notave

1. Ushtrimi i funksionit të prokurorit është i nivelit **jo të kënaqshëm**
2. Ushtrimi i funksionit të prokurorit është i nivelit të **kënaqshëm-mjaftueshëm**
3. Ushtrimi i funksionit të prokurorit është i nivelit të **suksesshëm**
4. Ushtrimi i funksionit të prokurorit është i nivelit të **suksesit mbi mesatar**
5. Ushtrimi i funksionit të prokurorit është i nivelit të **suksesit të dalluar**

**Neni 14**  
**Poenët e shprehur në notë**

1. Prokurori i cili ka arritura numrin e poenëve deri 50, vlerësohet me notën **niveli i kënaqshëm**
2. Prokurori i cili ka arritura numrin e poenëve prej 51-70, vlerësohet me notën nivel të **kënaqshëm-mjaftueshëm**
3. Prokurori i cili ka arritura numrin e poenëve prej 71-85, vlerësohet me notën nivel të **suksesshëm**
4. Prokurori i cili ka arritura numrin e poenëve prej 86-100, vlerësohet me notën nivel të **suksesit mbi mesatar**
5. Prokurori i cili ka arritura numrin e poenëve mbi 100, vlerësohet me notën nivel të **suksesit të dalluar**

**Neni 15**  
**Numri i përgjithshëm i poenëve**

1. Numri i përgjithshëm i poenëve për të gjitha kriteret është 100 poenë,
  - 1.2 Numri i poenëve bazuar në kriterin sasior është 50 poenë
  - 1.2 Numri i poenëve bazuar në kriterin kohorë është 20 poenë
  - 1.3 Numri i poenëve bazuar në kriterin e cilësisë është 20 poenë
  - 1.4 Numri i poenëve bazuar në kriterin bazuar në vetiniciativë është 10 poenë.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, prokurori i cili grumbullon më tepër se 100 poenë vlerësohet me notën **suksesi i dalluar**.

**Neni 16**  
**Kriteri i vlerësimit përshkrues**

Kriteri i vlerësimit përshkrues bazohet, por nuk kufizohet, në:

1. njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performancën, duke përfshirë njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
2. zotësinë për arsyetim ligjor;
3. aftësinë dhe zotësinë për analizimin e problemeve dhe zgjidhjeve ligjore;
4. aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, ndërgjegjshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi;
5. aftësitë e komunikimit;
6. aftësinë profesionale, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit në të cilën është vlerësuar performanca;
7. sjelljet brenda dhe jashtë zyrës si dhe integritetin personal, dhe
8. në notimin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës.

## **Neni 17**

### **Vlerësimi i prokurorëve në bazë të kriterit përshkrues**

1. Vlerësimin e prokurorëve e bënë Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me nenin 16 të kësaj rregullore.
2. Vlerësimin e kryeprokurorëve komunal e bënë Kryeprokurori i prokurorisë kompetente (qarkut).
3. Vlerësimin e prokurorëve të Prokurorisë Speciale e bënë Zëvendësprokurori i Prokurorisë Speciale .
4. Vlerësimin e kryeprokurorëve të qarkut, zëvendësprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe prokurorëve të prokurorisë së shtetit e bënë Kryeprokurori i Shtetit.

## **Neni 18**

### **Vlerësimi i kryeprokurorëve**

Vlerësimi i Kryeprokurorëve të Prokurorisë Komunale, Qarkut, Zëvendës kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe Prokurorëve të Prokurorisë së Shtetit, behët duke u bazuar në:

1. Kriteret për vlerësimin e përformances sipas nenit 2 të Kësaj rregullore dhe
2. Kriteret e veçanta-përshkruese si në vijim:
  - 2.1 Përkujdesja për ekspeditivitetin e punës së prokurorisë,
  - 2.2 Aftësitë e përgjithshme për të udhëhequr prokurorinë,
  - 2.3 Aftësi për të realizuar mbikëqyrjen e plotë të prokurorisë,
  - 2.4 Aftësi për avancimin e punës së prokurorisë
  - 2.5 Aftësi për ta menaxhuar prokurorin në situata krize dhe
  - 2.6 Notimi i prokurorisë gjegjëse nga Njësiti për Vlerësimin e Prokurorëve.

## **PROCEDURA E VLERËSIMIT**

### **Neni 19**

#### **Procedura e vlerësimit**

1. Njësiti detyrohet që vlerësimin e vet vjetor për secilin prokuror t'ia dërgojë kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse më së voni deri me datën 1 shkurt të vitit vijues.
2. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse detyrohet t'i paraqes njësitet raportin e vet vlerësues në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të vlerësimit nga njësiti.
3. Njësiti Vlerësimin e vet së bashku me vlerësimin përshkrues të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse ia dërgon secilit prokuror të vlerësuar më së voni gjer më 20 shkurt .
4. Prokurori i cili nuk pajtohet me vlerësimin ka të drejtë që në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të vlerësimit , të ushtrojë ankesë Këshillit, kundër vlerësimit të njësitetit, vlerësimit të kryeprokurorit apo të dy vlerësimeve.

5. Me rastin e shqyrtimit të ankesës, Këshilli mund të kërkojë sqarime shtesë nga njësitit dhe kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.
6. Këshilli, me rastin e shqyrtimit të ankesës mund të vendos t'i vërtetojë ose t'i ndryshojë vlerësimet.
7. Këshilli sipas detyrës zyrtare apo lidhur me ankesat merr vendimin përfundimtar për vlerësimin e punës të secilit prokuror, kryeprokuror dhe të secilës prokurori, më së voni deri me 31 mars.
8. Vlerësimi i njësitit, i kryeprokurorit dhe i këshillit duhet të arsyetohen.
9. Vlerësimi i njësitit dhe i kryeprokurorit janë konfidenciale.
10. Vlerësimi përfundimtar i Këshillit është dokument publik.

## **Neni 20**

### **Periudha e vlerësimit të prokurorit dhe prokurorisë**

1. Prokurorët dhe Kryeprokurorët do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit për çdo vit.
2. Për vlerësimin e punës së Kryeprokurorit të Shtetit vendos Këshilli.

## **Neni 21**

### **Pasojat e notimit**

1. Vlerësimi i prokurorit, me notën e nivelit **jo të kënaqshëm**, është shkak për fillimin e procedurës, për shkarkim nga detyra e prokurorit.
2. Vlerësimi i prokurorit, me notën e nivelit **të kënaqshëm-mjaftueshëm**, është shkak për dërgim të prokurorit në trajnime të detyrueshme.
3. Vlerësimi i prokurorit, me notën e nivelit **të suksesit të dalluar**, është bazë për avancim në pozitën e prokurorit të nivelit më të lartë.
4. Me rastin e propozimit e kandidatit për pozitën e kryeprokurorit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, do ta merre për bazë notën dhe numrin e poenëve të prokurorit në fjalë.

## **Neni 22**

### **Vlerësimi i performancës së Prokurorisë**

1. Vlerësimi i punës së Prokurorisë është rezultat i vlerësimit të punës së prokurorëve, kryeprokurorit dhe stafit mbështetës.
2. Vlerësimi i punës së stafit mbështetës të prokurorisë do të rregullohet me akt nënligjor të veçantë.
3. Vlerësimi i punës së prokurorisë bëhet për çdo vit.

## **Neni 23**

### **Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë me të cilën është nxjerr.



**Neni 24**  
**Zbatimi i rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit do të nxjerr Udhëzime të posaçme administrative .

**Neni 25**  
**Dispozitat kalimtare**

Pas miratimit të kësaj rregulloreje e deri në datën e hyrjes në fuqi, Njësiti do ta testoj aplikimin e kësaj rregulloreje në njërën nga prokurorit e Republikës së Kosovës

**25**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, hyn në fuqi nga 1 Janari i vitit 2012.

Miratuar me datë 29.08.2011

Kryetari i Këshillit Prokurorial

*Ismet Kabashi*  
Ismet Kabashi

